



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 17 tetor 2017

Numri i lëndës: 2016-08

Hamdi Hasani

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Eika ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar në Panel me datën 13 qershor 2016.

II. FAKTET

1. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
2. Në vitin 2014, ankuesi ka ngritur një padi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër një personi M.F. në mënyrë që të fitojë pronësinë e tokës së vet dhe të mbulojë humbjet e supozuara financiare. Në një datë të pasaktësuar, M.F. ka paraqitur një padi kundër ankuesit duke argumentuar se ky i fundit e kishte penguar atë të shfrytëzonte tokën e tij diku rreth vitit 2016.

3. Në një datë të mëvonshme, me sa duket këto grupe të procedurave ishin bashkuar. Mumentalisht ato janë ende në pritje.
4. Me 13 qershor 2016, i pakënaqur me mënyrën në të cilën gjykatat kishin shqyrtuan lëndën, ankuesi paraqiti një kërkesë me shkrim tek kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it i, të cila ishte marrë. Ai kërkoj nga gjyqtarët e EULEX-it të monitorojnë lëndën e tij civile që në atë kohë ishte në pritje në Gjykatën Themelore të Prishtinës.
5. Me letrën e datës 30 qershor 2016, kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it ka informuar ankuesin se Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në lidhje me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës - Ligji nr. 05L -103 kishte hyrë në fuqi me 29 qershor 2016. Në pajtim me atë Ligj, mandati i ri i gjyqtarëve të EULEX-it në fushën e të drejtës civile ishte i kufizuar në rastet që hyjnë në juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) rreth vendimeve të Komisionit i Kërkesave Pronësore të Kosovës.
6. Kryetari ka njoftuar parashtruesin e ankesës se lënda e tij nuk kishte hyrë në asnjërën prej kategorive të lëndëve të parapara me ligjin nr. 05/L-103 dhe prandaj gjyqtarët e EULEX-it nuk kanë kompetencë për t'u përfshirë në këtë lëndë.
7. Më tej kryetari ka informuar ankuesin se personi me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për punën e gjyqtarëve të Kosovës ishte kryetari i gjykatës përkatëse të Kosovës dhe se ai ka këshilluar ankuesin që shqetësimet e tij t'i adresonte te ai/ajo.
8. Po ashtu kryetari ka informuar ankuesin se nëse ai nuk ka marrë ndonjë përgjigje përkatëse nga kryetari i gjykatës përkatëse, ai mund t'ia referojë çështjen Zyrës së Këshillit Disiplinor të Kosovës që ishte kompetente për të hetuar sjelljet e supozuara të pahijshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës. Një monitorim i tillë do të ndihmonte që çështja të gjykohej në mënyrë të drejtë mbi dëshmi të padiskutueshme, fakte dhe argumente që do të parashtroheshin nga palët në seancat e ardhshme gjyqësore të mbajtura pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës.

II. ANKESAT

9. Pa pretenduar në ndonjë shkelle të të drejtave të tij të njeriut apo ndonjë dispozitë ligjore përkatëse, ankuesi kërkon që EULEX-i të monitorojë procedurat gjyqësore në të cilat ai ishte palë. Ankuesi gjithashtu thekson rëndësinë e një monitorimi të tillë si një mënyrë për të siguruar që "rasti të gjykohet në mënyrë të drejtë mbi dëshmi, fakte dhe argumente të padiskutueshme". Nga kjo duket se ankuesi ngrit çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e tij të garantuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore ("Konventa") dhe nenet 14/16 të Konventës Ndërkombëtare mbi të drejtat Civil dhe Politike.

III. LIGJI

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
12. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana.
13. Paneli thekson që ankesat e ankuesit kanë të bëjnë kryesisht me një mosmarrëveshje pronësore midis tij dhe M. F., ankesë që aktualisht është në pritje pranë gjykatave të Kosovës. Paneli rithekson se në parim, sipas rregullit 25 paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it Kosovë, nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës (në përgjithësi shih *Z.A. kundër EULEX-it*, 2014-36, 29 Shkurt 2016, § 17, *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014, § 13, *Shaban Kadriu kundër EULEX-it*, 2013-27, 27 maj 2014, § 17). Rrjedhimisht Paneli nuk ka juridiksion lidhur me aspektet administrative apo gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës.
14. Prandaj, çështja e ngritur në EULEX nga ana e ankuesit, e përmendur në paragraf 5 më lartë, nuk i ka dhënë kompetencë Panelit për të shqyrtuar lëndën.
15. Për më tepër, kur EULEX-i i ka shkruar ankuesit me 30 qershor 2016, në atë mënyrë ai nuk ka ushtruar autoritet ekzekutiv brenda kuptimit të Konceptit të Llogaridhënies së EULEX-it. Ai thjesht ka vepruar duke i dhënë parashtruesit të ankesës informata të përgjithshme lidhur me kufizimet e mandatit të vet dhe e ka këshilluar atë lidhur me mjetet juridike që mund të ishin në dispozicion të tij brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.
16. Rrjedhimisht, kjo ankesë bie jashtë kompetencave të Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë dhe në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës,

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese